



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.11, datë 5.2.2007

**PËR
NJË NDRYSHIM NË MËNYRËN E PAGESËS PËR ORKESTRËN FRYMORE DHE
ANSAMBLIN FOLKLORIK "TIRANA"**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32, gërma "ç", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.726, datë 21.12.2000 "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.297, datë 27.6.2002, ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.656, datë 25.9.2003, indeksuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.184, datë 10.4.2004, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Pika 2 e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.47, datë 1.10.2004, për pjesën e pagesës së instrumentistëve "me pagesë 2500 lekë në muaj për çdo aktivitet që do të kryejnë, por jo më shumë se 5000 lekë në muaj", shfuqizohet dhe ndryshohet si vijon:
"Pagesa për çdo instrumentist të jetë 2500 lekë për çdo aktivitet, por jo më shumë se 24 aktivitete në vit".
2. Pikat 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.16, datë 27.3.2006 "Mbi një ndryshim brenda strukturës së Qendrës Kulturore "Tirana" dhe shtesës në buxhetin e saj me qëllim riorganizmin e Ansambllit Folklorik "Tirana", respektivisht, "Pagesa e honorareve për 2 shfaqje në muaj sipas nevojave të Qendrës Kulturore "Tirana" (pika 1), "Koreopetitor / 1 vetë me kohë të pjesshme me pagesë 5000 lekë në muaj, instrumentistë / 7 vetë me kohë të pjesshme me pagesë 5000 lekë në muaj, valltarë / 22 vetë me kohë të pjesshme me pagesë 5000 lekë në muaj" (pika 2), shfuqizohen dhe ndryshohen si vijon:
"Pagesa për çdo punonjës të strukturës së Ansambllit Folklorik "Tirana" të jetë 2500 lekë për çdo aktivitet dhe jo më shumë se 24 aktivitete në vit (për pikën 1)
"Koreopetitor / 1 vetë me pagesë 2500 lekë për çdo aktivitet dhe jo më shumë se 24 aktivitete në vit, instrumentistë / 7 vetë me pagesë 2500 lekë për çdo aktivitet dhe jo më shumë se 24 aktivitete në vit, valltarë / 22 vetë me pagesë 2500 lekë për çdo aktivitet dhe jo më shumë se 24 aktivitete në vit (për pikën 2).
3. Ngarkohet Drejtorja e Kulturës Rinisë & Sporteve dhe Qendra Kulturore "Tirana" për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI